



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 400/05-14952
Dt: 23.09.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 7 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës, duke vendosur lidhur me kërkesën e Drejtorisë për Arsim për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve me nevoja të veçanta, me datën 23.09.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Arsim për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve me nevoja të veçanta për periodën kohore të vitit shkollorë 2023/2024 të cilët janë qytetarë të Komunës së Gjakovës, sipas evidencës të listës së Drejtorisë për Arsim.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Arsim për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve me nevoja të veçanta për periodën kohore të vitit shkollor 2023/2024 të realizojë procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerën totale prej 600€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Arsim.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kërkesa e Drejtorisë për Arsim me të dhënat e nxënësve përfitues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Arsim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit.


Ardian Gjiqi
Kryetar i Komunës së Gjakovës